



Datë: 20.03.2018

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Administrata Tatimore e Kosovës ,shpallë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Shtëpiak, dy(2) ekzekutues

Referenca: MF/ATK nr.01/03/2018

Koeficienti: Katër.pesë(4.5)

Mbikqyrësi: Drejtori Rajonal

Vendi i punës: Drejtoria Rajonale Pejë dhe Gjilan

Qëllimi i vendit të punës:

Shtëpiaku është përgjegjës për mirëmbajtjen e ndërtesës së Drejtorisë Rajonale, respektivisht benë pune te ndryshme ne kuadër te mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për tërë stafin e Drejtorise Rajonale.

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Kujdeset per mirëmbajtjen e ndërtesës së Drejtorisë Rajonale ne pjesët e brendshme dhe te jashtme;
2. Bën mirëmbajtjen e instalimit elektrik, ujit, inventarit dhe pajisjeve të tjera;
3. Ne rast te defekteve të mëdha, mban kontakte me serviset e specializuara dhe asiston me rastin e riparimeve;
4. Bën kyçjen dhe çkyqjen e nxemjes qendrore dhe te gjeneratorit elektrik, duke mbajtur edhe evidencën e derivateve te naftës te cilat janë te deponuara ne rezervuarët e këtyre paisjeve;
5. Mban Evidencën, Kontrollon dhe monitoron rezervuarin e derivateve te naftës cilat janë te vendosura ne lokacionet e Drejtorise Rajonale;
6. Bën mirëmbajtjen e oborrit dhe përkujdesët per lulet brenda dhe përreth ndërtesës se Drejtorisë Rajonale;
7. Kryen edhe punë te tjera sipas nevojës dhe kërkesës qe momenti i imponon.

Kërkesat/Kualifikimet:

- Të posedoj diplomë të shkollës se mesme.
- Aftësi komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;
- Te mos kenë dosje penale (te vertetuar me çertifikatë nga gjykata kompetente);
- Është e preferueshme te ketë se paku 1 vit përvojë pune ne punët dhe detyrat e shtëpiakut
- Është e preferueshme të ketë aftësi perdorimi te kompjuterit, se paku te programeve (Word , Excel dhe çasje ne Internet;)

Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Drejtorinë e Përgjithshme të Administratës Tatimore të Kosovës, e cila gjendet në adresën: Këndi i rrugëve "Bill Clinton" dhe "Dëshmorët e Kombit" p.n. në Prishtinë ose në web-faqen e Administratës Tatimore të Kosovës: www.atk-ks.org tek rubrika e punësimit.

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopje të dëshmive të kërkuara sipas Shpalljes për konkurs dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme të ATK-së në Prishtinë në Zyrën e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për vendin e punës, për të cilin konkurrioni.

Vetëm aplikacionet zyrtare të Administratës Tatimore do të pranohen.

Njoftimi do të jete i hapur për dorëzimin e aplikacioneve 15 ditë nga dita e publikimit , duke filluar nga data 20.03.2018 gjer më datën 03.04.2018, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Divizioni i Burimeve Njerëzore